



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 195/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër, vëzhguesit të subjektit politik Partia demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të kryerjes së detyrës e cila nuk i është caktuar, gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

I Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Kaçanik i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2600 (dymijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për të u dërguar pastaj në buxhetin e Republikës së Kosovës.

II Adem Ceka, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit me nr. 0702D/02D, në Qendrën e Votimit në Gllloboçicë, i ndalohet për 1 (një) vit të marrë pjesë në Zgjedhje të organizuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Republikës së Kosovës, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

III Selajdin Luma, në cilësinë e vëzhguesit të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në QV 0702D/02D, në Gllloboçicë, i ndalohet për 1 (një) vit të marrë pjesë në Zgjedhje të organizuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Republikës së Kosovës, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 18.06.2012 PZAP, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 17 Qershor 2012, nga mëngjesi deri në orën 13:30, vëzhguesi i subjektit politik të PDK-së, Selajdin Luma, ka luajtur rolin e zyrtarit të spërkatjes së gishtërinjve. Parashtruesi i ankesës pretendon se këtë veprim e ka lejuar

edhe Kryesuesi i Vendvotimit, dhe se ky rast ka ndodhur në fshatin Gllloboçicë në Qendrën e Votimit 0702D/02D.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj vëzhguesit të subjektit politik të PDK-së, dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri me datë 19.06.2012, deri në ora 15:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Anr.195/2, PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, i cili në përgjigjen e tij ndaj ankesës thekson se lidhur me Vendvotimin 0702D/02 në Gllloboçicë, vëzhguesi i PDK-së, Selajdin Luma ka qenë vëzhgues i PDK-së, dhe nuk e ka luajtur rolin e kryesuesit të vendvotimit, por vetëm në një rast e ka zëvendësuar kryesuesin për një minutë, deri sa ai ka shkuar në tualet.

PZAP, me datën 19.06.2012, nëpërmjet telefonit ka bërë audio incizimin e deklaratës së dhënë nga Kryesuesi i Vendvotimit Adem Ceka në QV 0702D/02D, i cili deklaroi se gjatë ditës nuk ka pasur asnjë vërejtje nga ana e subjektit politik LVV, po ashtu deklaroi se në vendvotim ka qenë edhe një Komisioneri i subjektit LVV, i cili ka deklaruar se votimi ka qenë tejet korrekt dhe demokratik, ndërsa sa i përket vëzhguesit të PDK-së, Selajdin Luma, deklaruesi thekson se ai nuk ka qenë zyrtar i spërkatjes së gishtit, mirëpo meqenëse, për një moment është krijuar një tollovi e madhe në vendvotim dhe meqenëse është reduktuar numri i komisionerëve nga 7 në 5, e kemi dërguar për të i ndihmuar në mënyrë që turma të kalojë sa më shpejt, nga arsyeja se ka pasur edhe njerëz të moshuar duke pritur, dhe e krejt kjo ka ndodhur vetëm dy minuta pasi që kemi pasur fluks të madh të votueseve, dhe këta dy minuta kanë qenë pasdite. Gjithashtu komisioneri i VV, deklaroi se nuk kemi pasur asnjë vërejtje në librin e votimit, nga vëzhguesit, komisionarët, as nga Komisionarët Komunal për Zgjedhje (KKZ), e as nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e bazuar

Parashtruesi i ankesës pretendon se vëzhguesi i subjektit politik i PDK-së, Selajdin Luma, ka luajtur rolin e zyrtarit të spërkatjes së gishtërinjve, në QV 0702D/02D, në fshatin Gllloboçicë, të cilin sipas parashtruesit këtë e ka lejuar edhe Kryesuesi i Vendvotimit, e që është në kundërshtim me nenin 79 paragrafi 2 pika b), i LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;

- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, pas vlerësimit të gjitha provave të administruara, dhe duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat, konstatoi se nga ana e subjektit politik PDK dhe nga ana e Kryesuesit të Vendvotimit në QV 0702D/02D të subjektit politik PDK, kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore të lartë përmendura siç pohohet edhe në vetë përgjigjen e subjektit politik PDK dhe në deklaratën e dhenë nga KVV-ja në të cilat theksohet se shkelja ka ndodhur vetëm për dy minuta. PZAP-i konstatoi se veprimet e KVV-së dhe të vëzhguesit të PDK-së janë në kundërshtim me neni 79 paragrafi 2 pika b), të LZP-së. Prandaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c), neni 120 paragrafi 3 pika (d) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP, nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 195 /2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

